

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Kukës International Airport sh.p.k (më poshtë referuar si "Shoqëria") është themeluar dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar. Shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në datë 31 Janar 2019, me NIPT L97531201R.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: 3.5 km në jug të qytetit të Kukësit, Aeroporti i Kukësit, Shtigen, Kukës.

Shoqëria "Kukës International Airport" sh.p.k është një shoqëri e themeluar më datë 31.01.2019 në përbushje të kushteve të kontratës së koncesionit", të lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si Autoriteti Kontraktor, si dhe bashkimit të shoqërive "Global Technical Mechanics" shpk dhe "Bami" shpk si Koncessionari.

Kjo marrëveshje është miratuar me Vendimin të Këshillit të Ministrave me Nr. 146, datë 20.3.2019, publikuar në Fletoren zyrtare me Nr. 41, Datë 28.03.2019.

"Shoqëria" është subjekt i themeluar me qëllim të vecantë dhe ka objekt vëprimtarie "Rikonstruksion, Operim dhe Transferim i Aeroportit të Kukësit, si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjeter të nevojshëm, ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përbushjes së këtij objektivi.

Periudha e koncessionit fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij ("Periudha e Koncesionit"). Periudha e koncessionit është 35 (tridhjetë e pesë) vjet.

Kapitali i shoqërisë "Kukës International Airport" sh.p.k. është 10,000,000 Lekë.

Kukës International Airport është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortakë si më poshtë:

- "Global Technical Mechanics" shpk, zotëruese e 30% të kapitalit të shoqërisë,
- "Bami" shpk, zotëruese e 70% të kapitalit të shoqërisë.

Numri i punonjësve të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 është 69 persona.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrrëgjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **2.5.2. Provizonet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### **2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvèc rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**



Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
EUR/LEK	120.76	123.70
USD/ LEK	106.54	100.84

### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç së përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten së përshkruhet më poshtë.

Një instrument finanziar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provisionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njoftes fillojnë, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njoftur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njoftura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finansiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e zhvlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e zhvlerësuar për vitin 2021 është si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Mobilje për zyre	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta the vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)**

##### **iv. Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### **3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme.

#### **3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i viti përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e tē ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vitit, duke aplikuar normat tatile në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatile. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së **detyrimeve të bilancit**, duke aplikuar normën tatile në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatile. Gjendjet e shtyra tatile maten me normat tatile në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatile e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatile të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatushëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatesë sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### **3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12. Provizonet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

#### **3.13. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



#### 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në bankë		
Llogari rrjedhëse	46,244,297	723,765
Mjete monetare në arkë	<u>477,464</u>	<u>6,453</u>
	<u><b>46,721,761</b></u>	<u><b>730,218</b></u>

#### 5. Llogarite e arketueshme tregetare afatshkurtra

Llogarite e arketueshme tregetare afatshkurtra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientë në lekë	13,035,953	-
	<u><b>13,035,953</b></u>	<u>-</u>

#### Llogari te arketueshme nga palet e lidhura

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	1,811,400	-
	<u><b>1,811,400</b></u>	<u>-</u>

#### Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
TVSH e kreditueshme	323,468,995	5,899,663
Parapagime	11,386,041	2,269,205
Të tjera të arkëtueshme	<u>4,468,120</u>	<u>4,576,900</u>
	<u><b>339,323,156</b></u>	<u><b>12,745,768</b></u>

**Inventarë**

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Materiale dhe Lëndë të para	2,735,498	-
	<b><u>2,735,498</u></b>	<b><u>-</u></b>

**6. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzime të shtyra për konsulencë projekti	94,146,147	79,193,359
Shpenzime të shtyra për studim fizibiliteti	11,497,057	1,633,277
Shpenzime të shtyra për siguracione	9,041	9,041
Shpenzime të shtyra për studim gjeologjik	2,332,465	2,332,465
	<b><u>107,984,710</u></b>	<b><u>83,168,142</u></b>

**7. Aktive afatgjata materiale**

	AJM	Mobiljile dhe orendi	Kompjutera	Mjete transporti	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	71,030	9,200	551,607	5,496,760	580,000	6,708,596
Shtesa	7,662,369	5,875,678	20,927,257	2,566,875	20,670,389	57,702,569
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>7,733,399</b>	<b>5,884,878</b>	<b>21,478,864</b>	<b>8,063,635</b>	<b>21,250,389</b>	<b>64,411,166</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	(6,230)	(463)	(14,021)	(1,634,090)	(77,650)	(1,732,454)
Amortizimi i viti	(9,720)	(651,001)	(2,957,302)	(1,051,462)	(1,912,851)	(6,582,336)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(15,950)</b>	<b>(651,464)</b>	<b>(2,971,323)</b>	<b>(2,685,553)</b>	<b>(1,990,501)</b>	<b>(8,314,790)</b>
<i>Vlera neto kontabë/</i>						
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>64,800</b>	<b>8,737</b>	<b>537,586</b>	<b>3,862,670</b>	<b>502,350</b>	<b>4,976,143</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>7,717,449</b>	<b>5,233,414</b>	<b>18,507,541</b>	<b>5,378,082</b>	<b>19,259,888</b>	<b>56,096,376</b>



## **8. Hua afatshkurtra**

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Hua 1	10,698,136	32,729,250
Hua 2	-	12,370,000
	<b>10,698,136</b>	<b>45,099,250</b>

## **9. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,363,158,302	19,562,692
	<b>1,363,158,302</b>	<b>19,562,692</b>

## **10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të pagueshme ndaj Global Technical Mechanics sh.p.k	228,690,696	66,682,940
	<b>228,690,696</b>	<b>66,682,940</b>

## **11. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,205,127	169,303
Tatim ne burim	16,575	-
Tatimi mbi të ardhurat personale	827,097	131,592
Te tjera	81,360	-
	<b>2,130,159</b>	<b>300,895</b>

## 12. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime ndaj personelit	4,804,928	4,404,983
Detyrime të tjera	<u>10,004,185</u>	<u>7,233,114</u>
	<b><u>14,809,113</u></b>	<b><u>11,638,097</u></b>

## 13. Kapitali

Kapitali i shoqërisë "Kukës International Airport" sh.p.k. është 10,000,000 lekë, i ndarë në 2 kuota, një me vlerë 3,000,000 lekë, dhe një me vlerë 7,000,000 lekë.

## 14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Sherbime aeroportuale	7,766,502	-
Të ardhura nga qiraja	13,048,170	-
Sherbime interneti	12,000	-
Sherbim hapesira parkimi	2,520,000	-
TE ardhura nga marketingu	<u>13,042,250</u>	<u>-</u>
	<b><u>36,388,922</u></b>	<b><u>-</u></b>

### Të ardhura/Shpenzime të tjera të aktivitetit të shfrytëzimit, neto

Të ardhurat e tjera të aktivitetit të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(4,143,899)	(812,743)
Të ardhura nga këmbimet valutore	<u>14,256,219</u>	<u>45,620</u>
	<b><u>10,112,320</u></b>	<b><u>(767,123)</u></b>



### **15. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostojë e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	6,849,971	1,553,927
Nenkontraktive	3,652,900	-
Shpenzime për sigurim kontrate	410,616	9,041
	<b>10,913,487</b>	<b>1,562,968</b>

### **16. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Ruajtja e objekteve	10,490,833	11,869,829
Qira makine	3,260,841	4,457,756
Tatime dhe taksa	943,564	3,637,972
Udhëtime dhe dieta	6,386,059	1,599,241
Shpenzime për pritje percjellje	8,249,012	482,614
Mirëmbajtje dhe riparime	1,537,927	153,817
Komisione bankare	290,619	140,600
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,181,295	121,606
Shpenzime marketingu dhe promocionesh	452,668	107,237
Shpenzime për tarife informacioni ASHK	1,236,554	82,000
Shpenzime kancelarie dhe printimi	1,809,667	34,224
Shpenzime për raport ndikimi mjedisor VNM	-	30,000
Shpenzime për zyrat	292,093	24,153
Sponsorizime dhe dhurata	643,454	21,086
Shpenzime të tjera	15,500	18,600
Konsulencë ligjore	-	-
Shpenzime per shronesime	7,294,102	-
Trajnime personeli	2,219,601	-
	<b>46,303,789</b>	<b>22,780,735</b>



## 17. Paga dhe shpërblime

Paga dhe shpërblime detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime për paga dhe shpërblime	45,050,886	8,227,778
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	6,323,411	863,122
	<b><u>51,374,297</u></b>	<b><u>9,090,900</u></b>

## 18. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Penalitete dhe gjoba	225,226	29,134
	<b><u>225,226</u></b>	<b><u>29,134</u></b>

## 19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(65,818,895)	(35,258,745)
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	1,033,449	2,338,361
Shpenzime për pritje përcjellje	687,884	70,606
Shpenzime të tjera	120,339	2,238,622
Penalitete, gjoba	225,226	29,134
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	(64,785,446)	(32,920,384)
Humbje fiskale e mbartur	-	(14,869,866)
<i>Tatim fitimi 15%</i>	-	-
	<b><u>(65,818,895)</u></b>	<b><u>(35,258,745)</u></b>



Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

Për vitin e mbyllur  
më 31 dhjetor 2021

**Rakordimi i të ardhurave me FDP-në**

Të ardhura nga diferencat e kursit	14,256,259
Shitje total te deklaruara ne FDP TVSH	36,388,922
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>50,645,141</b>
<b>Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit</b>	<b>50,645,141</b>

**20. Transaksionet me palët e lidhura.**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si më poshtë:

	Të pagueshme	Të pagueshme
Global Technical Mechanics sh.p.k	228,690,696	66,682,940
	<b>228,690,696</b>	<b>66,682,940</b>

**21. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve te shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2021, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

**22. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

